



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. 011/01-13698/2022

Datë: 26.05.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi Propozim Vendimit për themelimin e Komisionit Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale Tregu në Orize, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të Pronës së paluajtshme Komunale "Tregu në Orize" në pjesën e parcelës me numër 5127-3 me sipërfaqe prej 1100 m² Z.K Gjakovë J Qytet, me këtë përbërje:
 1. Z. Flamur Fetahaj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
 2. Z. Shkumbim Kastrati, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
 3. Znj. Lirianda Dahsyla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 4. Znj. Shqipe Fejza, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 5. Z. Idriz Daci, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Besiana Shyti

From: Burim Bajrami
Sent: Monday, May 30, 2022 11:37 AM
To: Besiana Shyti
Subject: kekres per permiresimine gabimit teknik
Attachments: Vendimi 13698 i dt. 26.05.2022

Te nderuar !

Te bashkangjitur e gjeni vendimin 01 nr.011/01-13698 të datës 26.05.2022 të përmirësuar nga gabimi teknik që ka ndodhë gjatë hartimit të këtij akti në pikën 1 tek anëtarët e komisionit gabimisht është shënuar znj. Krenare Bushaj , ndërsa duhet të jetë znj. Lirianda Dahsyla andaj pasi që e kemi përmirësuar po ju dërgojmë të përmirësuar këtë vendim .

Me respekt !

Burim Bajrami
Udhëheqës i Sektorit për punë të Kuvendit Komunal
Komuna e Gjakovës
Tel. 03820044068
Mob. 044637580